



Republika e Kosovës
Republika Kosova/ Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në mbështetje të nenit 7, paragrafi 1, nënparagrafi 1.12 dhe 1.31 të Ligjit nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, me qëllim të rregullimit të normës orientuese për prokurorët e shtetit me mandat fillestar gjatë periudhës së trajnimit fillestar në Akademinë e Drejtësisë, në takimin e mbajtur më 27 korrik 2023, miraton:

**UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 03/2023 PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E
UDHËZIM ADMINISTRATIV NR.01/2018 PËR ÇAKTIMIN E NORMËS ORIENTUESE
PËR PROKURORËT E SHTETIT**

Neni 1

Neni 2 të Udhëzimit Administrativ bazë i shtohet paragrafi 2, si në vijim:

2. Prokurorët e departamenteve të përgjithshme të prokurorive themelore gjatë trajnimit fillestar në Akademinë e Drejtësisë mund t'u caktohen raste nën mbikëqyrjen e mentorit, 10 kallëzime - lëndë penale gjatë një (1) muaji, përkatësisht 110 kallëzime-lëndë penale të kryerësve madhorë të veprave penale gjatë një viti.
 - 2.1.Sipas nevojës, ndarja lëndëve për prokurorët gjatë trajnimit fillestar në Akademi mund të bëhet në mënyrë manuale nëse nuk është e mundur përmes sistemit elektronik SMIL.
 - 2.2.Prokurorët gjatë trajnimit fillestar në Akademi mund të marrin pjesë vetëm në shqyrtimin fillestar. Përfundimisht mund të marrin pjesë edhe në shqyrtimin kryesor me prezencën e mbikëqyrësit - mentorit.

Neni 2

Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe fillon të zbatohet nga data 1 gusht 2023.

Prishtinë më, 27 korrik 2023

Jetish Maloku
Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës